



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 874/25

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga Kryetarja në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje prej: Batisha Ibrahim - Kryetare, Vedat Poterqoi - Anëtar si dhe Isa Hasani - Anëtar, duke u bazuar në nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës dhe konform nenit 32 të Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020 (e amendamentuar), pas shqyrtimit të kërkesës së AK – Komuna Prizren, me numër 874/25, për zbatim të nenit 99.2 LPP-së, ndaj OE Archi Time Sh.p.k, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndertimi i infrastruktures ne lagjen Bajram Curri, me nr: te prokurimit: 622-25-1862-5-1-1, iniciuar nga Komuna Prizren, më: 08.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

1.APROVOHET, si e bazuar në dispozitën ligjore të nenit 99 par. 2 të LPP-së, kërkesa e Autoritetit Kontraktues – Komuna Prizren, për diskualifikim nga pjesëmarrja në prokurimin publik të OE Archi Time Sh.p.k - Prizren, me nr: unik 810200212, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndertimi i infrastruktures ne lagjen Bajram Curri, me nr: te prokurimit: 622-25-1862-5-1-1, iniciuar nga Komuna Prizren dhe i njejt i diskualifikohet nga pjesmarrja ne prokurimin publik per nje periudhe prej një (1) viti, nga data: 08.08.2025 deri me 07.08.2026.

A R S Y E T I M

Kërkesa e AK- Komuna Prizren:

1. Autoriteti kontraktues pretendon se OE Archi Time Sh.p.k, si pjesëmarrës ne aktivitetin e prokurimit me titull: Ndertimi i infrastruktures ne lagjen Bajram Curri, me nr: te prokurimit: 622-25-1862-5-1-1, ka mashtruar me deshmit e dorezuara me arsyetimin se gjate vleresimit te ofertave kemi bere verifikimin e listes se stafit profesional. Konkretisht gjate vleresimit te ofertave AK – Komuna e Prizrenit ka verejtur se deshmit e inxhinierit D. Kabashi dhe inxhinierit I. Lekaj, jane dorezuar ne oferten e OE Kab Holding dhe ne oferten e OE Archi Time, pjesmarres ne aktivitetin e lartpermendur.

2. Autoriteti kontraktues, permes kerkeses per sqarim, i eshte drejtuar dy inxhinierëve të përmendur më lartë, me qëllim të sqarimit të dëshmiëve/dokumentacionit të dorëzuar në ofertën e OE Kab Holding dhe në ofertën e OE Archi Time.
3. Në përgjigje të kerkeses së Autoritetit Kontraktues, inxhinierët kanë deklaruar:

Deklarimi i inxh. D.Kabashi:

1. A kam bërë autorizim me OE KAB Holding SH.P.K. për këtë projekt?

Po, unë, Defrim Kabashi, me numër personal 1007935460, kam autorizuar ekskluzivisht kompaninë KAB Holding SH.P.K. (numër unik i biznesit: 811897977) për të përdorur kualifikimet dhe përgatitjen time profesionale si udhëheqës i punishtës për tenderin publik me numër 622-25-1862-5-1-1, "Ndërtimi i Infrastrukturës në Lagjen Bajram Curri - Projekt tre vjeçar". Autorizimi është dhënë me dokumentin e datës 24.04.2025, i noterizuar nga noter Festim Zeqiri në Suharekë (LRP.nr.270/2025). Në këtë dokument, unë kam deklaruar qartë se KAB Holding SH.P.K. është e vetmja e autorizuar për të përdorur kualifikimet e mia për këtë tender dhe se çdo përdorim tjetër i të dhënave apo kualifikimeve të mia nga ndonjë palë tjetër pa pëlqimin tim me shkrim është i ndaluar dhe përbën shkelje ligjore.

2. A kam bërë marrëveshje me OE Archi Time SH.P.K. për këtë projekt?

Jo, unë nuk kam nënshkruar asnjë marrëveshje bashkëpunimi me OE Archi Time SH.P.K. për projektin "Ndërtimi i Infrastrukturës në Lagjen Bajram Curri" me numër prokurimi 622-25-1862-5-1-1. Dokumenti i paraqitura nga Archi Time SH.P.K., "Marrëveshja e Bashkëpunimit" i datës 25.04.2025 me pretendimin se përmban nënshkrimin tim, është i falsifikuar. Nga analiza e dokumentit PDF të paraqitur nga Archi Time SH.P.K., është e qartë se nënshkrimi im është vendosur si fotografi (shih imazhet e mëposhtme), e cila dallohet edhe nga cilësia e dobët e imazhit, duke treguar se është kopjuar pa pëlqimin tim nga një dokument tjetër publik i disponueshëm në internet ose burime të tjera. Unë nuk kam nënshkruar kurrë ndonjë marrëveshje me Archi Time SH.P.K. për asnjë projekt, dhe përdorimi i paautorizuar i emrit dhe nënshkrimit tim nga kjo kompani përbën shkelje ligjore.

Deklarimi i inxh. I.Lekaj:

Unë, Ibrahim Lekaj, Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë – drejtimi Hidroteknik, përmes kësaj deklarate zyrtare dëshiroj të njoftoj Zyrën e Prokurimit të Komunës së Prizrenit se:

Asnjë dokument profesional apo personal, përfshirë diplomën, CV-në, certifikatat apo dëshmitë e përvojës sime të punës, nuk është i autorizuar për t'u përdorur nga subjekti ekonomik:

ARCHI TIME SH.P.K., me numër biznesi 810200212, në pronësi të z. Dashnor Ndrecaj.

Theksoj se ky operator ekonomik ka përdorur dokumentacionin tim pa autorizimin tim, çka përbën shkelje të rëndë të të drejtave të mia personale dhe profesionale.

Mbi bazen e sqarimeve te dhena me larte, autoriteti kontraktues kerkon marrjen e masave eventuale sipas nenit 99.2 te LPP-se me pretendimin se OE Archi Time Sh.p.k, ka paraqitur dokumente me permbajtje te rreme ose te falsifikuar, njeherit AK-ja, i ka bashkangjitur deklaratat e inxhinierëve, autorizimet qe te drejten e perdorimit te deshmieve e ka vetem OE Kab Holding.

Kërkesa e OSHP-se drejtuar Operatorit Ekonomik:

Organi Shqyrtues i Prokurimit, me te pranuar kërkesën e datës: 23.06.2025, te AK - Komuna Prizren, e ka njoftuar OE Archi Time Sh.p.k, me qellim qe operatori ekonomik ne fjale te jap faktet dhe argumentet e veta lidhur me kërkesën e AK-se.

OE Archi Time Sh.p.k, në përgjigje te kërkesës se OSHP-se ka dhene faktet dhe argumentet e veta lidhur me pretendimet e AK-se duke e kundërshtuar ne tërësi pretendimin e AK-se dhe njeherit ka sqaruar se angazhimi i dy inxhinierëve është bërë nëpërmjet bashkëpunësorëve tanë të jashtëm dhe paleve të treta me të cilët kemi pasur marrëveshje për përdorimin e dokumentacionit të tyre në aktivitete të ndryshme të prokurimit. Këto palë janë autorizuar per te krijuar marreveshje bashkepunimi për inxhinierët në fjalë dhe ne zotohemi qe dokumentacionin te cilin e kemi bashkangjitur ne ofera tone ne prokurim pubik jane ata dokuemntet te cilat i kemi pranuar keto palë.

Me tutje OE Archi Time ka deklaruar se me z. Ibrahim Lekaj kemi bashkëpunuar më parë në projekte të tjera të prokurimit publik dhe asnjëherë nuk ka pasur kontestime apo pretendime për përdorim të paautorizuar. Kjo tregon qartë se ka pasur një marrëdhënie bashkëpunimi, e cila me shumë gjasë është keqkuptuar ose interpretuar ndryshe në këtë rast të veçantë.

Nga komunikimi ynë me palët që kanë qenë ndërmjetëse, jemi informuar se inxhinierët në fjalë, **z. Defrim Kabashi dhe z. Ibrahim Lekaj**, janë të gatshëm të sqarojnë se ka ndodhur një **keqkuptim**. Ne ju inkurajojmë që të kontaktoni drejtpërdrejt me ta për të verifikuar këtë pohim.

Qëllimi ynë asnjëherë nuk ka qenë të prezantojmë dokumente të rreme apo të falsifikuara, dhe në asnjë rast nuk ka pasur ndonjë përfitim të paligjshëm. Nëse ka pasur ndonjë mospërputhje teknike në dokumentacion apo ndonjë element të paqartë, kjo ka ndodhur për shkak të procesit të ndërlikuar të koordinimit me bashkëpunësorët e shumtë dhe jo si rezultat i ndonjë veprimi të qëllimshëm.

Përfundim:

Në bazë të të gjitha sa më sipër u tha, kërkojmë që OSHP të mos e shqyrtojë kërkesën për diskualifikim si të bazuar, pasi ajo nuk përmbush elementet e kërkuara sipas nenit 99 të Ligjit për Prokurimin Publik për të justifikuar një masë kaq të rëndë dhe të dëmshme për imazhin dhe aktivitetin e një Operatori Ekonomik që ka ushtruar aktivitetet të ndershem në treg për një kohë të gjatë.

Vlerësimi i pretendimeve të autoritetit kontraktues për marrjen e masave ndaj OE Archi Time Sh.p.k:

Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të kërkesës së autoritetit kontraktues, dhe arsyeshmërisë së dhënë nga OE Archi Time, provave të ofruara nga AK – Komuna e Prizrenit Archi Time Sh.p.k, deklaratave të inxhinierëve, diskutimeve dhe shoshitjes së provave paneli shqyrtues vlerëson se ka prova me të cilat deshmohet se OE Archi Time, ka keqpërdor/mashtruar autoritetin kontraktues, me dëshmit e dorezuara në oferte.

Paneli shqyrtues, sa i përket deklaramit të OE Archi Time, se në të kaluarën kemi pasur bashkëpunim me inxhinierin D. Kabashi dhe se inxhinieret në fjalë janë të gatshëm të sqarojnë keqkuptimin e ndodhur, nuk qëndron sepse OSHP, e ka njoftuar me kërkesën e AK-se, dhe OE Archi Time, ka dhënë deklaramin e me sipërm dhe njëherit ka pasur mundësin të ofroje edhe prova tjera apo sqarime tjera nga inxhinieret dhe perkundrazi nuk ka ofruar asnjë prove apo sqarim tjetër nga inxhinieret e D. Kabashi dhe I. Lekaj.

Për marrjen e masave ndaj operatorëve ekonomik Organi Shqyrtues i Prokurimit mund veproj vetëm nëse AK-ja, ka ofruar prova ashtu siç potencohet në nenin 99 të LPP-së, në të cilin flitet për funksionet dhe kompetencat e OSHP-së, në paragrafin 2 të këtij neni, ku thuhet: Në bazë të një kërkeje me shkrim nga autoriteti kontraktues në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik, OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë dhe të diskualifikojë operatorin ekonomik nga pjesëmarrja në prokurim publik për një periudhë deri në një (1) vjeçare, e që në rastin konkret AK-ja, me dëshmit e prezantuara ka prova për paraqitje të dokumenteve të rreme apo të falsifikuara nga ana e OE Archi Time Sh.p.k, për aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i infrastruktures në lagjen Bajram Curri”, me nr: të prokurimit: 622-25-1862-5-1-1 dhe njëherit paneli shqyrtues, sqaron faktin se inxhinieret D. Kabashi dhe I. Lekaj kanë dorezuar deklarata me shkrim se të drejtën e përdorimit të dokumenteve e ka vetëm OE Kab Holding, duke ja bashkangjitur edhe autorizimin përmes të cilit të drejtat e përdorimit/aplikimit në aktivitete të prokurimit e ka vetëm OE Kab Holding.

Andaj, paneli shqyrtues vlerëson se OE Archi Time Sh.p.k, duhet, **të diskualifikohet në kohëzgjatje prej një (1) viti, nga pjesëmarrja në prokurim publik, për të gjitha procedurat e prokurimit, ashtu si është e përcaktuar me nenin 67.9, Rregullorja për Prokurim Publik Nr. 002/2024, si në vijim**” Në rast se OSHP nxjerr një vendim për diskualifikim të një operatori ekonomik nga pjesëmarrja në prokurimin publik prej datës së vendimit. Për qëllime të zbatimit të këtij neni, “Pjesëmarrja në prokurim publik” është një proces që përfshin tërë ciklin nga njoftimi, aplikimi, përfshirë edhe çfarëdo kundërshtimi apo ankese, deri të vendimi për dhënie të kontratës, rrjedhimisht pamundëson çfarëdo veprimi që Operatori Ekonomik mund të ndërmerr përgjatë tërë procesit të prokurimit prej fazës së publikimit të njoftimit për kontratë deri në momentin e nënshkrimit të kontratës, përfshirë edhe parashtrimin e ankesave. Ky përjashtim vlen për të gjitha llojet e kontratave dhe për të gjitha procedurat e prokurimit”.

Paneli shqyrtues, duke u mbështetur nenin 99.2 te LPP-së si dhe në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente për anulim vendimi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Prizren

1x1 OE Archi Time Sh.p.k

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

